



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më __. __. 2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

**“PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE ME ÇMIME TË REDUKTUARA PËR PËRFITUESIT E
KARTËS SË STUDENTIT”**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet sot në Elbasan, më datë ___/___/2024, ndërmjet palëve të mëposhtme:

Bashkia Elbasan, me adresë Rruga 11 Nëntori, Elbasan , Tel: 054 400 152 Elbasan , Shqipëri, përfaqësuar nga **ZV/Kryetari Armand Shehu**, *këtu e më poshtë referuar si “Bashkia Elbasan”*;

Dhe

SHERBIMEAdresa;

këtu më poshtë referuar si “Ofruesi i Shërbimit”.

DUKE QENË SE:

- Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.226, datë 17.4.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit” dhe Udhëzimit Nr. 3, datë 13.02.2024 , për disa ndryshime dhe një shtesë në Udhëzimin Nr.14, datë 27/05/2019 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit”, e cila është një dokument unik identifikues në bazë të së cilës të gjithë individët që gëzojnë statusin e studentit në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Elbasan kanë të drejtë që të përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara dhe/ose falas nga subjekte publike dhe private.
- Bashkia Elbasan për realizimin e objektivave të marra përsipër në kuadër të projektit të Kartës së Studentit synon nëpërmjet mbështetjes operative të burimeve të saj të krijojë një sistem nëpërmjet të cilit të vendosë në kontakt studentët të cilët posedojnë Kartën e Studentit me operatorë ekonomik privat, të cilët do të ofrojnë shërbimet e tyre për këta të fundit me çmime të reduktuara.
- Ofruesi i Shërbimit ushtron veprimtari sipas rregullave në fuqi dhe shpreh interesin për të bashkëpunuar me Bashkinë Elbasan për të qenë pjesë e rrjetit të subjekteve private që do të aderojnë në iniciativën sipas objektit të kësaj marrëveshjeje.

- Palët vlerësojnë se zbatimi dhe krijimi i një bashkëpunimi në kuadër të Kartës së Studentit do të jetë në interes të përbashkët në përgjigje të nevojave të studentëve.

Palët, në konsiderim të kushteve paraprahe si më sipër ranë dakord me njëra-tjetrën për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Përkufizime

1.1 Termat e mëposhtëm, sa herë që përdoren në këtë marrëveshje, do të kenë kuptimin e parashikuar në këtë nen:

- a. **“Karta e Studentit”** është dokument unik identifikues me numër identifikues matrikullimi (NIM) i lëshuar nga Bashkia Elbasan, mbajtësi i të cilit është përfitues i shërbimeve, me çmime të reduktuara, sipas termave të kësaj marrëveshjeje.
- b. **“Student”** është çdo individ që gëzon statusin e studentit të regjistruar pranë institucioneve të arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtari në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Tiranë i pajisur me Kartë Studenti.
- c. **“Shërbime”** do të ketë kuptimin e shërbimeve apo produkteve të ofruara nga Ofruesi i Shërbimit me çmime të reduktuara sipas përcaktimeve në këtë marrëveshje.
- d. **Vendi i dhënies së shërbimit/shërbimeve** do të jetë njësi apo njësitë tregtare ku zhvillon aktivitet tregtar Ofruesi i shërbimit.

Neni 2

Objekti i Marrëveshjes

2.1 Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi ndërmjet palëve për dhënien nga ofruesi i shërbimit të shërbimit/shërbimeve me çmime të reduktuara për Studentët e pajisur me Kartë Studenti sipas listës së shërbimeve dhe çmimeve përkatëse të përcaktuara në Aneksin 1 bashkëngjitur.

2.2 Palët bien dakort që të bëjnë publike dhe të deklarojnë Ofruesin e shërbimit si pjesë e rrjetit të operatorëve ekonomik privat të projektit të kartës së studentit.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

3.1 Ofruesi i shërbimit merr përsipër të ofrojë në favor të çdo Studenti të pajisur me Kartë Studenti të interesuar për shërbimin/shërbimet që ofron pranë njësisë/njësive ku zhvillon aktivitetin e tij konform çmimeve të reduktuara sipas listës së shërbimeve dhe çmimeve të përcaktuara në Aneksin 1 bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje.

3.2 Ofruesi i shërbimit merr përsipër të veprojë në raport me Studentin mbajtës të Kartës së Studentit me drejtësi, ndershmëri, mirëbesim, korrektësi, vullnet, transparencë dhe barazi.

3.3 Bashkia Elbasan do të pajisë çdo Student me kartë studenti të rregullt, me anë të së cilës ky i fundit ka të drejtë t'ia paraqesi Ofruesit të Shërbimit për të përfituar shërbimin/shërbimet me çmime të reduktuara sipas përcaktimeve në Aneksin 1.

3.4 Bashkia Elbasan do të regjistrojë e deklarojë në faqen institucionale të saj një seksion të dedikuar për projektin Karta e Studentit në të cilin do të publikohet lista e Ofruesve të shërbimit, në të cilën do të përfshihet emërtimi i Ofruesit të Shërbimit dhe oferta e çmimeve të reduktuara për shërbimin/shërbimet që ofron.

3.5 Bashkia Elbasan merr përsipër të promovojë nëpërmjet të gjitha kanaleve të saj të komunikimit në dispozicion ku përfshihen të gjitha komunikimet zyrtare dhe eventet publike si edhe në faqen zyrtare të saj projektin për Kartën e Studentit dhe seksionin e dedikuar iniciativave dhe ofertave të subjekteve ofruese të shërbimit/shërbimeve që mbështesin këtë projekt.

Neni 4

Deklarata dhe garanci të Ofruesit të shërbimit

4.1 Ofruesi i shërbimit, deklaron dhe garanton secilën prej çështjeve të mëposhtme në datën e Nënshkrimit:

4.2 Ofruesi i shërbimit nuk ka filluar apo gjendet në proces falimenti apo likuidimi;

4.3 Ofruesi i shërbimit disponon të gjitha autorizimet/lejet/liçensat e nevojshme nga organet kompetente për ushtrimin e rregullt të aktivitetit të deklaruar;

4.4 Ofruesi i shërbimit respekton normat ligjore në lidhje me kushtet e sigurisë dhe kushteve të punës në vendin ku do të ofrohet shërbimi/shërbimet;

4.5 Ofruesi i shërbimit do të ruajë konfidencialitetin e informacionit dhe nuk do të paragjykojë, në asnjë formë, interesat e akorduar studentëve titullar të kartës së studentit.

Neni 5

Personat e kontaktit

5.1 Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu edhe shkresore. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje personat e kontaktit janë si vijon:

Për Bashkia Elbasan :

Adresa: Rruga 11 Nëntori, Elbasan, Shqipëri

Email: bashkiaelbasan@elbasani.gov.al

Nr.Tel: 054 400 152

Për Ofruesin e shërbimit: **SHERBIME**Adresa;

.....

Nr.Tel:

Neni 6

Afati

6.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi ofrohet dhe pranohet për një periudhë 2 (dy) vjeçare duke filluar nga data e nënshkrimit me të drejtë rinovimi automatik.

6.2 Kjo marrëveshje mund të përfundohet në çdo kohë nga secila prej palëve, duke dhënë njoftim me shkrim nga njëra Palë tek tjetra, një (1) muaj përpara datës së përfundimit.

Neni 7

Dispozitat e fundit

7.1 Kushtet paraprake ashtu dhe Aneksi 1, lista e shërbimit/shërbimeve dhe çmimet bashkëngjitur janë pjesë integrale e kësaj marrëveshje.

7.2 Asnjë shtesë, modifikim ose amendament i kësaj marrëveshje nuk do të jetë detyrues përveç në rast se ai do të bëhet me shkrim dhe do të jetë i nënshkruar rregullisht prej Palëve.

7.3 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët.

7.4 Kjo marrëveshje hartohet në 2 (dy) kopje të barasvlershme në gjuhën shqipe, nga 1 (një) kopje origjinale për ofruesin e shërbimit dhe 1 (një) kopje origjinale për Bashkia Elbasan.

PALËT

PERSON FIZIK

BASHKIA ELBASAN

Përfaqësuesi

Me Urdhër Delegim

ANEKSI 1

SHERBIME Adresa;

Për të gjitha si më poshtë shërbimet do të aplikohet ulje për studentët dhe oferta të tjera gjatë gjithë periudhës 2-vjeçare (me të drejtë ripërtëritje) të marrëveshjes.

Lista e shërbimit/ çmimi/

Çmimi i reduktuar (oferta për studentët)